



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

P- 021

Prishtinë, më 2 e 3 qershor 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
2 QERSHOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 87 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6 pika 2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, Kryesia e Kuvendit, në takimin e përbashkët me shefat e grupeve parlamentare, të mbajtur sot, vendosi që t'i propozojë Kuvendit heqjen e pikës 8 dhe të pikës 10, si dhe plotësimin me pikën shtesë - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimvendimin e Qeverisë për aprovimin e buxhetit për vitin 2008 për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Kuvendi i vazhdoi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 16, 20 dhe 21 maj 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punën,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statistikën zyrtare,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbarese,
6. Shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të Kosovës për vitin 2007,
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit,
8. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpalljen e Trasesë për ndërtimin e Autoudhës Morinë -Merdar dhe Prishtinë – Hani i Elezit, si zonë me interes të veçantë publik në Kosovë,

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtur më 16, 20 dhe 21 maj 2008

Procesverbalet e seancave plenare të mbajtur më 16, 20 dhe 21 maj 2008 u miratuan pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Suzan Novobrdaliu**, i parashtoi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, lidhur me licencimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të veprimtarisë së pompave të gazit në Kosovë?

Ministri **Mahir Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Novobrdaliu**.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtoi pyetje Kryeministrit, se çfarë masash ka marrë Qeveria që ta ndihmojë popullatën për ta përballuar ngritjen e çmimeve që kanë ndodhur në kohën e fundit në Kosovë?

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Syla**.

Deputeti **Hajdin Abazi** i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë nëse kjo ministri ka ndonjë strategji për furnizimin e QKU-së me barnat e nevojshme ?

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Abazi**.

Deputetja **Gjylnaze Syla**, i parashtoi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, se sa do t'i kushtojnë Buxhetit të Kosovës, reformat fiskale, zvogëlimi në paga - nivelet e tatimit, por edhe të korporatave, të cilat janë paralajmëruar nga kjo Qeveri.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Syla**.

Deputeti **Armend Zemaj**, i parashtoi pyetje ministrit të Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural, se çfarë masash ka marrë kjo ministri për parandalimin e prerjeve të paligjshme të pyjeve në hapësirat që shtrihen nga Bjeshkët e Strellcit, Gryka e Deçanit e deri mbi Zharre, te Kosharja mbi fshatin Botushë.

Ministri **Idriz Vehapi** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Zemaj**.

Deputeti **Naser Rugova**, i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë nëse kjo ministri ka ndonjë plan konkret për ofrimin e përkujdesjes shëndetësore dytësore për qytetarët shumicë të regjionit të Mitrovicës.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Naser Rugova**.

Deputeti **Naser Rugova**, i parashtoi pyetje ministrit të Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural, se çfarë masash ka marrë kjo ministri për parandalimin e dukurisë së hyrjes në tregun kosovar të sasive të

mëdha të produkteve ushqimore me afat të skaduar, e cila është tejet të dëmshme, në radhë të parë për shëndetin e qytetarëve, por edhe për prodhuesit vendorë.

Ministri **Idriz Vehapi** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rugova**.

Deputetja **Suzan Novobrdaliu**, i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit lidhur me Programin Braingain, apo Mbledhje e Trurit të Inteligjencës

Ministri **Enver Hoxha** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Novobrdaliu**.

Deputeti **Driton Tali**, i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit se a ka ndonjë plan strategjik Qeveria, respektivisht kjo ministri lidhur me problemin e braktisjes së shkollimit nga nxënësit.

Ministri **Enver Hoxha** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Tali**.

Deputetja **Edita Tahiri**, i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me atë se çfarë masash ka marrë kjo ministri për parandalimin e zhvillimit të projekteve të paligjshme në Parkun Nacional në Prevallë të Prizrenit.

Ministri **Mahir Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Tahiri**.

Pyetjet që nuk morën përgjigje në seancën e sotme, ngase nuk premtoi koha (50 minuta), mbeten për të marrë përgjigje në seancën e radhës.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punën

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për punën.

Ministri i Punës dhe të Mirëqenies Sociale **Nenad Rashiq**, gjatë prezantimit të Projektligjit tha se Projektligji për punë ka qenë në Qeverinë e kaluar të Kosovës, më 2006, kurse më 2007 ka qenë edhe në Parlamentin e Kosovës, por është tërhequr sipas rekomandimit të disa ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë, për ripunim.

Momentalisht është në fuqi Rregullorja 2001/27, e cila sigurisht nuk e plotëson spektrin e gjerë të nevojave që janë përcaktuar me Ligjin e punës dhe kjo rregullore konkretisht i ka 28 akte ose 28 amendamente, kurse Projektligji i ri për punë do t'i përmbante 104, që do të thotë se është zgjeruar veprimi i Projektligjit për punë.

Projektligj për punë ka rekomandimin nga ana e Organizatës Ndërkombëtare të Punës -ILO.

Qëllimi i këtij ligji është t'i rregullojë të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e punëdhënësit dhe të punëmarrësit në kuadër të marrëdhënies së punës dhe siguron: zbatimin e drejtë të marrëveshjes dhe të rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, përf forcimin e punës së Inspektoratit të Punës për eliminimin e tregut ilegal të punës, me theks mbi tregun informal të punës, krijimin e balancit për sigurimin e të drejtave dhe të interesave midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, shmangien e pasojave negative në marrëdhëniet e punës dhe eliminimin e shumë parregullsive në procesin e punës, veçanërisht në sektorin privat, krijimin e kushteve optimale për themelimin e organizatave që angazhohen për interesin e të punësuarve dhe interesin e punëdhënësve të tyre dhe avancimin e të drejtave dhe të beneficioneve të tjera nga marrëdhënia e punës.

Miratimi Projektligjit për punë do të kontribuojë në masë të konsiderueshme në zbatimin e ligjeve të tjera sekondare, siç janë: Ligji për Inspektoratin e Punës, Ligji për sigurimin dhe mbrojtjen në punë, Ligji për rritjen e punësimit dhe mbrojtjen e të punësuarve, Ligji për mbrojtjen e grave, Ligji për të drejtën dhe lirinë e organizimit të sindikatave, Ligji për evidencën e të punësuarve, Ligji për punësimin e shtetasve të huaj, si dhe të ligjeve të tjera që i rregullojnë segmentet e caktuara nga fusha e punës dhe e punësimit.

Në fund, ministri **Rashiq** i ftoi deputetët ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin në parim, të Projektligjit për punën.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për punën i dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Teuta Hadri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Nurishahe Hulaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser Rugova**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Radmila Vujovic**, si dhe deputetët **Mimoza Ahmeti**, **Myrvete Pantina**, **Bahri Hyseni**, **Flora Brovina**, **Suzan Novobrdaliu** dhe **Ibrahim Makolli**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 49;
Kundër----- 7.
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për punën.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale – si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statistikat zyrtare

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për statistikat zyrtare.

Zëvendëskryeministri, **Ramë Manaj**, gjatë prezantimit të Projektligjit tha se qëllimi i këtij projektligji është të përcaktojë parimet themelore dhe të krijojë kornizën ligjore për organizimin dhe prodhimin e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës.

Projektligj përcakton kornizat kryesore për grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare në Kosovës.

Ky projektligj përbëhet prej 12 pjesëve me gjithsej 50 nene dhe rregullon statusin dhe financimin e Agjencionit Republikan të Statistikave, si dhe përgjegjësitë dhe detyrat, pozitën e kryeshefit ekzekutiv të ARS-së, përbërjen, organizimin dhe përgjegjësitë e këshillit statistikor, pastaj përfshinë masat planifikuese, programuese dhe zbatuese të statistikave zyrtare, grumbullimin e të dhënave statistikore, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave statistikore, e të tjera.

Projektligji është në përputhshmëri me *acquis-comunitaire* dhe standardet ndërkombëtare .

Në fund, zëvendëskryeministri Ramaj i ftoi deputetët ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për statistikat zyrtare..

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për statistikat zyrtare dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Fehmi Mujota**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makoll**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Rasim Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Slobodan Petrović**, si dhe deputeti **Armend Zemaj**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63;
Kundër----- 0.
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për statistikat zyrtare.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media – si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbaruese

Kryetari i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për procedurën përmbaruese, si dhe me raportet e komisioneve kryesor dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1,2,3,4,5,6,7, 8,9,10,11,12,13,14,15,16, 17,18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishte si vijon:

Për----- 68;
Kundër----- 0.
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për procedurën përmbaruese.

6. Shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të Kosovës për vitin 2007

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Raportin financiar të Buxhetit për vitin 2007.

Ministri i Ekonomisë dhe Financave, **Ahmet Shala**, duke e paraqitur Raportin financiar tha se plani buxhetor për realizimin e të hyrave vjetore 2007 ka qenë 682.800.000 euro, plani buxhetor për pagesat vjetore ka 764.273.000 euro duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura nga viti 2006, të cilat nuk janë të planifikuara në Rregulloren e buxhetit.

Ai e paraqiti këtë raport në katër shtylla edhe atë në të hyrat, shpenzimet, grandet dhe gjendja e mjeteve në kesh.

Të hyrat përkatësisht pranimet gjatë vitit 2007, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve, si dhe fondin e privatizimit, kanë qenë 2.998.000 euro dhe paraqesin 132,2% të të hyrave të përgjithshme vjetore të planifikuara. Kjo tregon një rritje vjetor të të hyrave krahasuar me planin vjetor për 32%. Në këtë rritje ndikim ka pasur sidomos licenca e operatorit të dytë të telefonisë mobile prej 75 milion euro.

Pjesa më e madhe e të hyrave janë mbledhur në kufi në pjesën prej 58,9%, pra rreth 60% të mjeteve janë të mbledhura nga doganat. Këto dy hyra kapin shumën prej 531.591.000 euro, që tregon për një tejkalim 21%. Të hyrat nga administrata tatimore janë të mbledhura 182.542.000 euro ose 20,2% dhe janë mbi vlerën e planifikuar për 30%. Të hyrat komunale në totalin e përgjithshëm të hyrave marrin pjesë prej 3,2% e që janë në fakt ende shumë të ulëta. Megjithatë, këtu ka pasur gjithashtu një tejkalim plani prej 4%. Të hyrat vetanake të nivelit qendror në totalin e përgjithshëm të hyrave marrin pjesë me 2,8% dhe janë shumë prej 25.724.000 euro. Të hyrat jo tatimore qeveritare paraqesin 6,5% , përkatësisht një tejkalim të realizuar prej 1.44 të treguesit të indeksit. Kësaj kategorie duhet t'i shtohet edhe të hyrat nga gjobat të cilat mbledhen nga komunat për regjistrimin e të hyrave jo tatimore dhe pastaj atyre ju alokohen.

Shpenzimet gjatë vitit 2007, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve, si dhe fondin e privatizimit, kanë qenë 661.208.000 euro dhe paraqesin 86,5% të planit të përgjithshëm. Krahasuar me vitin paraprak, pra të vitit 2006, shihet një rritje vjetore e shpenzimeve dhe kryesisht në kategorinë e investimeve kapitale. Shpenzimet nga kategoritë e pagave dhe të mëditjeve janë 208.513.000 euro ose janë 32% të realizuara 96,3%. Shpenzimet e mallrave 127.018.000 euro, 19% të shpenzimeve ose të realizuara 87,5%. Shpenzimet për shërbime komunale janë në shumë prej 17.893.000 euro apo 3% të shpenzimeve të përgjithshme, ndërsa realizimi ndaj tyre është bërë 93,1%. Subvencione dhe transfere 153.000.000 euro, që përfshinë 23% të shpenzimeve të përgjithshme dhe të realizuara 94,7%. Te shpenzimet kapitale, siç dihet, ekzekutimi është në nivel të ulët, megjithatë përfshinë 154.767.000 euro ose 23% të shpenzimeve dhe të realizuara vetëm 70%, megjithatë, në krahasim me vitin 2006 ka 16% ngritje.

Grandet e përcaktuara të donatorëve. Fondi i grandeve të përcaktuara të donatorëve të bartura nga viti 2006 në 2007 ka qenë 12.949.000 euro si gjendje fillestare, si dhe të hyrat nga grandet e vitit 2007 në shumën prej 14.885.000 euro që paraqesin fondin e përgjithshëm të grandeve të përcaktuara për vitin 2007 në shumën prej 27.834.000 euro. Nga ky fond, në vitin 2007 janë shpenzuar 15.496.000 euro dhe janë bërë kthime në shumë prej 1.070.000 euro, ku shihet se gjendja e fondeve të grandeve të përcaktuara të donatorëve më 31.12. 2007 janë 11.267.000 euro.

Gjendja e mjeteve të gatshme. Më 31.12.2007 janë 856.010.000 euro. Mirëpo, nga kjo gjendje rrjedhin detyrime, siç është fondi për donatorë 11.267.000 euro, të hyrat vetanake 28.725.000, fondi i privatizimit 406.248.000, fondet tjera në shumën prej 12.626.000 euro dhe nga kjo pas shpërndarjes, pra më 31 dhjetor, shuma prej 397.144.000 euro janë para të cilat kanë qenë në dispozicion të Qeverisë së Kosovës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit financiar të Buxhetit të Kosovës për vitin 2007.

Gani Koci, në emër të Komisioni për Buxhet e Financa, tha se ky Komision e ka shqyrtuar këtë Raport dhe në parim e ka miratuar.

Ai shtoi se raporti përmban të gjitha karakteristikat që parasheh neni 40 i Ligjit të menaxhimit të financave publike, por nuk dallon nga raportet e viteve të tjera që d.m.th se nuk përmban detajet e të hyrave dhe detajet e shpenzimeve, nuk jep informata të nevojshme dhe përshkrime për aktivitetet financiare dhe për

suficit, përkatësisht pse ai suficit, nga ai suficit, si është menaxhuar dhe si do të menaxhohet në këtë vit ky suficit?

Raporti nuk përshkruan pasqyrën e shpenzimeve dhe mënyrën e shpenzimit të mjeteve që kanë qenë të dedikuara për statusin e Kosovës, gjë që do të ishte mirë që edhe opinioni edhe Kuvendi të njihet me këtë fond dhe me mënyrën e shpenzimeve nga ky fond.

Megjithatë, Kuvendit i propozoi ta miratojë këtë Raport, ndërsa Qeveria në të ardhmen duhet të marrë parasysh këtë vërejtje.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit financiar të Buxhetit të Kosovës për vitin 2007.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për Raportin financiar të Buxhetit të Kosovës për vitin 2007 dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safet Hadergjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxherri**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Slobodan Petrovic**, si dhe deputetët **Xhevdet Neziraj**, **Driton Tali**, **Ramadan Avdiu**, **Besa Gaxherri** dhe **Armend Zemaj**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij Raport. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 46;
Kundër----- 13.
Abstenime-----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin financiar të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2007

8. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpalljen e Trasesë për ndërtimin e Autoudhës Morinë-Merdar dhe Prishtinë – Hani i Elezit, si zonë me interes të veçantë publik në Kosovë

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit se Qeveria ka hartuar Projektin për shpalljen e hapësirës së trasesë për ndërtim të autoudhës Morinë-Merdarë dhe Prishtinë Hani i Elezit, zonë me interes të veçantë publik në Kosovë dhe ka kërkuar nga Kuvendi miratimin e tij.

Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, **Fatmir Limaj**, duke e paraqitur këtë projekt tha se Qeveria përmes strategjisë zhvillimore mbështet fuqishëm tezën se infrastruktura transportuese është parakusht i domosdoshëm për një zhvillim të mbarë ekonomik të vendit tonë, si dhe për integrim funksional në infrastrukturën transportuese regjionale dhe atë evropiane.

Drejtimit rrugor Morinë-Merdarë dhe Prishtinë-Hani i Elezit janë dy autorrugët me prioritet të rrjetit dhe të transportit rrugor të Kosovës, të cilat do të lidhin Kosovën me pjesët e tjera të Ballkanit Jugor, nga Jugu me portin e Durrësit në Shqipëri, me Korridorin 8 të rrugëve panevropiane, dhe nga Veriu me Korridorin 10 të rrugëve panevropiane. Këto korridore kanë potencial për zhvillimin ekonomik të vendeve të Ballkanit Jugor, me detin Adriatik dhe me vendet e Mesdheut.

Ndërkaq, autorruga Prishtinë – Hani i Elezit, lidhet me Korridorin 8 dhe 10 me rrugët kryesore panevropiane të transportit, që mundëson gjithashtu lidhjet më të mira që përbëjnë impulse të reja të zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

Sa i përket autostradës Morinë – Merdarë, është përfunduar projekti zbatues, studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi të ndikimit në mjedis, është realizuar evidencimi i pronave si dhe janë bërë paramatjet dhe parallogaritë specifike dhe teknike, përveç që në këtë projekt zbatues janë evidentuar disa mangësi, të cilat duhet të plotësohen, sidomos në pjesën e studimeve të gjeomekanikës.

Gjatësia e përgjithshme e trasesë është 117 kilometra. Autostrada lidhë dy pikat kufitare, nën kyçje, 105 ura dhe tre tunele me gjatësi totale 5 kilometra, me mundësi të ndryshimeve. Sipërfaqja e nevojshme për ndërtim është: $S = 1062.2786$ ha, prej të cilave është $S = 376.2420$ ha ose 35.42% është pronë shoqërore dhe 686.0366 ha ose 64% e saj është pronë private. Kostoja e përgjithshme, atëherë kur është bërë projekti, është llogaritur në 659.000.000 euro, ndërsa tani do të shihet sipas çmimeve të tregut.

Ekzekutimi i punimeve në segmentin e parë Vërmicë – Prizren pritet të fillojë gjatë këtij viti.

Autostrada Prishtinë – Hani i Elezit ka një gjatësi rreth 75 km., ndërsa segmenti A i trasesë kryesore të saj do të jetë 35 km. Ministria e Transportit vlerëson se zgjidhja më e mirë për një investim afatgjatë në këtë korridor është të ndërtohet një rrugë e re, me parametra të autostradës.

Prandaj, duke e marrë parasysh dobinë ekonomike që mund t'i sjellin këto dy autostrada dhe sidomos interesin e veçantë nacional për shtetin tonë, Kuvendit i propozoj që ta miratojë këtë projekt.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Propozimprojektit të Qeverisë.

Gani Koci, në emër të Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se ky Komision, në mbledhjen e mbajtur më 23 prill 2008, ka shqyrtuar këtë propozim të Qeverisë dhe Kuvendit i rekomandon me sa vijon : që propozim projekti të miratohet, ndërsa Qeverisë i ka rekomanduar që sa më parë të insistoje që të nënshkruhet Ligji mbi shpronësimet, i miratuar vitin e kaluar, sepse pikërisht kjo ka të bëjë me fillimin e shpronësimeve në këtë hapësirë me interes të veçantë. Po ashtu, Komisioni ka kërkuar nga ministria përkatëse që shumë shpejt t'i adresojë Kuvendit Projektligjin për koncesionet dhe në fund rekomandohet që në projektet e tilla të ngjashme gjithnjë të kërkohet shpallja e interesit të veçantë.

Muzejene Selmani, në emër të Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, tha se ky komision e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Projektvendimin e Qeverisë dhe të ndërmarrë veprime procedurale në Zyrën e PSSP-së për shpalljen e Ligjit për shpronësim nr. 2L97 të miratuar në Kuvendin e Kosovës më 8.02.2007 dhe t'i rekomandojë Qeverisë të themelojë një Komision të pavarur profesional që do t'i raportojë Kuvendit të Kosovës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë gjatë shpronësimit të zonës nëpër të cilën do të ndërtohet auto-udha Morinë-Merdarë dhe Prishtinë-Hani i Elezit.

Eqrem Kryeziu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës tha se e përkrah propozimin e Qeverisë.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se e përkrah propozimin e Qeverisë, ndërsa kërkoj sqarime nga ministri lidhur me çështjen e rrugës 6, do të thotë, rruga Hani i Elezit – Prishtinë – Pejë dhe kufi me Malin e Zi, i cili ka qenë një segment i përbashkët, pse është hequr gjysma e kësaj rrugës 6, përkatësisht pjesa prej Prishtinës deri në Pejë dhe në kufi me Malin e Zi dhe kërkoj të shpallet zonë me interes të posaçëm.

Ministri **Fatmir Lima** tha se tani me këtë projekt do të fillojmë me kapacitetin që e kemi, për ndërtimin e rrugës së parë ose me autostradën e parë, kufi Vërmicë – Merdarë, por normalisht në vitin e ardhshëm do të vazhdojmë për Shkup – Prishtinë, për të vazhduar në drejtim të Pejës.

Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së tha se lidhja e Kosovës me rajonin dhe korridoret 8 dhe 10 si korridore panevropiane është tejet e rëndësishme dhe është një investim kapital dhe ka ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit. Megjithatë, siç edhe u cek, pa Ligjin për shpronësimet, Ligjin për koncesione, i cili ka kaluar njëherë nëpër këtë sallë të këtij Parlamenti në legjislaturën e kaluar dhe është në Zyrën e PSSP-së, nuk mund të mendohet realizimi i këtij projekti.

Heset Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, tha se ky projekt i Qeverisë, përkatësisht këto dy akse rrugore mundësojnë lidhjen me Korridorin 10, i cili kalon nëpër Serbi dhe me Korridorin 8 që kalon, po ashtu, nëpër Republikën ish-jugosllave të Maqedonis, janë të një rëndësie të veçantë për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Megjithatë, për t'u realizuar ky projekt, ne mendojmë se duhet të implementohet Ligji për shpronësimin e tokës, si dhe të bëhen studime më të hollësishme për variantin e parë dhe të dytë dhe Qeveria të dalë me një propozim konkret për variantin që do të ishte më optimal për realizimin në praktikë.

Sadik Idriz në emër të Grupit Parlamentar “7 +”, tha se e përkrah projektin e Qeverisë dhe shtoi se ky projekt është i interesit nacional, prandaj duhet përkrahur edhe Ministrinë përgjegjëse që ta vazhdoj punën.

Slobodan Petrovic, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, tha se duke e konsideruar Projektin e Qeverisë si shumë të rëndësishëm, ky grup e mbështet plotësisht propozimin, ndërsa Ministrinë përgjegjëse e inkurajon në punën e mëtutjeshme me qenë se këto rrugë kanë shumë rëndësi jo vetëm për komunitetin Serb të Kosovës, por edhe për të gjitha komunitetet e tjera që jetojnë dhe janë shfrytëzues të këtyre rrugëve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për Propozimvendimit e Qeverisë për shpalljen e Trasesë për ndërtimin e Autostradës Morinë -Merdar dhe Prishtinë – Hani i Elezit, si zonë me interes të veçantë publik në Kosovë, i dhanë edhe deputetët : **Zafir Morina, Adem Salihaj, Kaqusha Jashari, Ibrahim Makolli**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij Projektpropzimi të Qeverisë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60;

Kundër----- 1.

Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Qeverisë së Kosovës për shpalljen e hapësirës– trasesë për ndërtimin e Autostradës Morinë – Merdar dhe Prishtinë – Hani i Elezit zonë me interes të veçantë publik në Kosovë.
2. Ngarkohet Qeveria e Kosovës t'i marrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

9. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë për aprovimin e buxhetit për vitin 2008 për Ministrinë e Punëve të Jashtme

Kryetari i njoftoi deputetët e Kuvendit lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë për aprovimin e buxhetit për vitin 2008 për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Ai e ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, t'i paraqesë rekomandimet e këtij komisioni.

Gani Koci, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa tha se edhe pse kërkesa e Qeverisë nuk i plotëson kushtet e domosdoshme ligjore, megjithatë duke pasur parasysh rëndësinë e themelimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme në këtë periudhë, Komisioni e ka miratuar këtë kërkesë të Qeverisë, por tërheq vërejtjen që për kërkesa të tilla të bëhen plane të detajizuara si e kërkon Ligji mbi buxhetin për vitin 2008.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Propozimvendimit të Qeverisë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58;
Kundër----- 1.
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 1.000.000 € për Ministrinë e Punëve të Jashtme.
2. Mjetet buxhetore nga paragrafi 1 i këtij vendimi ndahen nga Fondi -Rezervat për implementimin e statusit.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe e Financave ta zbatojë këtë vendim.

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit se Agjencioni Kundër Korrupsionit, në bazë të obligimeve ligjore me kohë ia ka dorëzuar Kuvendit Raportin vjetor për vitin 2007.

Kryetari kërkoi një deklaram nga seanca për të lejuar drejtorin e Agjencionit që t'i drejtohet seancës nga foltorja e Kuvendit.

Për: shumicë votash
Kundër: nuk ka

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin që drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit t'i drejtohet Kuvendit.

Hasan Preteni –Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, pasi përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit, tha se aktivitetet e Agjencionit në vitet që i lamë pas janë mbështetur në tri shtylla kryesore: në zbatimin ose fuqizimin e ligjit, parandalimin e korrupsionit ose eliminimin e shkaqeve të korrupsionit dhe në aktivitetet lidhur me edukimin.

Fuqizimi i ligjit, aktivitetet e veçanta në trajtimin e informatave që qytetarët i sollën në Agjencion, hetimi i tyre dhe përcjella e tyre në prokuroritë publike të Kosovës. Gjatë vitit 2007, në Agjencion janë trajtuar 124 informata. Pas hetimeve administrative, në 61 raste, ato në mungesë të provave janë mbyllur. 47 informata janë dërguar në prokuroritë gjegjëse dhe në fund të vitit 2007 16 informata kanë qenë në fazën e hetimeve.

Nga informatat e përcjella në prokurori, 14 i përkasin gjyqësorit, 13 Qeverisë, 11 pushtetit lokal dhe 9 ndërmarrjeve publike. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht Kodin penal të Kosovës, natyra e rasteve sipas veprave penale është si në vijim: shpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autorizimet, 12 raste, përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, 9 raste, marrja e ryshfetit, 10 raste, ushtrimi i ndikimit, 4 raste, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, 7 raste, arkëtimi dhe pagesa e paligjshme, 2 raste falsifikimi i dokumentacionit zyrtar, 3 raste.

Nga faktet e sjella, nga rastet e dyshuara për veprime korruptive, të cilat janë përcjellë për procedim penal të mëtutjeshëm në prokuroritë përkatëse, pasojat ekonomike që mund ta dëmtojnë shoqërinë kosovare kapin shifrën rreth 30 milion euro. Nga informatat e përcjella në prokurori, në mënyrë zyrtare jemi informuar për fatin e vetëm 6 prej tyre. Në mesin e tyre 5 informata janë që i përkasin gjyqësorit, dhe 1 rast që është nga pushteti lokal.

Parandalimi, eliminimi i shkaqeve të korrupsionit, mbikëqyrja e pasurisë, edhe pse ky aktivitet është realizuar për herë të parë në Kosovë, 98% e zyrtarëve e kanë kryer këtë obligim. Ky obligim ligjor është realizuar në tri faza dhe deri te realizimi i plotë është dashur që ndaj 24 zyrtarëve të kërkohej ndërmarrja e masës administrative - zvogëlimi i pagës për 20%, kurse ndaj 14 zyrtarëve, nga punëdhënësit e tyre është kërkuar largimi definitiv nga puna.

Parandalimi i konfliktit të interesit, në bazë të informatave të bazuara për ekzistimin e konfliktit të interesit, Agjencioni ka ndërhyrë tek 15 raste dhe është arritur evitimi i tyre. Në disa raste ku janë vërejtur shkeljet e Ligjit të prokurimit publik, nga ana e institucioneve të Kosovës, Agjencioni ka ndërmarrë veprime ku janë rekomanduar anulimet e disa tenderëve dhe iniciativa tjera të institucioneve para hapjes së ofertave, duke eliminuar diskriminimin e operatorëve të përgjegjshëm ekonomik, vlera e paralogaritur e tenderëve të anuluar arrin shifrën rreth 7 milionë.

Edukimi, Agjencioni si institucion i ri i formuar nga Kuvendi, aspektin e edukimit e ka trajtuar në dy drejtime. Edukimin në ngritjen profesionale të vetë zyrtarëve të Agjencionit dhe edukimi i përgjithshëm i publikut me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare.

Zyrtarët e Agjencionit gjatë vitit raportues kanë marrë pjesë në gjithsej 35 trajnime, konferenca, tryeza pune dhe vizita studimore.

Për të gjitha aktivitetet e Agjencionit janë shpenzuar 336 mijë e 956 euro ose 88.11% nga buxheti i lejuar. Duke menaxhuar mirë buxhetin dhe duke shpenzuar për: telefonata, dreka, darka dhe derivate shpenzime minimale, vetëm 5% e buxhetit është shpenzuar në procedura me vlerë minimale.

Pengesat në punën e Agjencionit për vitin raportues kanë qenë të dukshme dhe kryesisht kanë pas të bëjnë me mungesën e buxhetit, me numrin i zyrtarëve jo sipas organo-gramit, pagat e vogla dhe aspak motivuese, pamundësia e angazhimit të ekspertëve të fushës përkatëse dhe rrezikshmëria e largimit të personelit ekzistues, bashkëpunimi me prokuroritë jo në nivelin e duhur si dhe objekti ku është vendosur Agjencioni është i vogël dhe jofunksional.

Agjencioni është në funksion më shumë se një vit dhe ky është raporti i parë që po prezantohet para jush. Jam shumë i bindur se rezultatet e arritura janë larg asaj çka ne dëshirojmë, mirëpo mendoj se në Kosovë është formuar një institucion i cili veç ka krijuar një themel të fortë, një institucion tek i cili qytetarët e Kosovës po e rrisin besimin dhe me vazhdimin e përkrahjes së institucioneve qendrore, në një të ardhme të afërt do të arrihen rezultate të dëshirueshme.

Ndryshimet në këtë vit kanë të bëjnë se tani Agjencioni për herë të parë e ka buxhetin sipas kërkesës. Numri i zyrtarëve definitivisht do të jetë sipas organogramit. Kuvendi po ndërmerr hapa konkret drejt fuqizimit të

Agjencionit dhe në raport me prokuroritë ka progres. E gjithë kjo po rezulton me rritjen e intensitetit dhe kualitetit të punës së Agjencionit.

Fjalimin e plotë të Hasan Pretenit – Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, mund ta gjeni në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtij raporti.

Gani Koci, në emër të Komisionit për Buxhet e Financa, pasi falënderoi drejtorin e Agjencionit Kosovë Kundër Korrupsionit, për raport e shkurtër, të saktë dhe shumë real për punën njëvjeçare të Agjencionit, tha se Komisioni e ka shqyrtuar këtë raport dhe e kemi vlerësuar lart mënyrën e raportimit dhe transparencën që vërtet do të duhej të ishte shembull për të gjitha institucionet qeveritare të Kosovës dhe për të gjithë mekanizmat tjerë dhe agjencionet e pavarura se si duhet vepruar dhe në fund si duhet raportuar para organit që edhe i ka zgjedhur si mekanizëm.

Megjithatë, shqetësimet e Komisionit kanë qenë që mekanizmat që janë të thirrur, të jenë hallkë në luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e korrupsionit, si fenomen shumë i keq për shoqërinë, nuk e luajnë atë rol dhe atë mision për të cilin janë të thirrur, dhe pamundësojnë kështu punën dhe zbardhjen e rasteve nga ana e Agjencionit. Kështu, nga 35 raste të paraqitura për gjykata, 14 janë në prokurori dhe vetëm dy janë në procedurë. Kjo tregon efikasitetin e këtij mekanizmi dhe në këtë drejtim unë thërras edhe Qeverinë edhe Ministrinë e Drejtësisë, që vërtet sa më parë të fillojë një reformë në sistemin gjyqësor, në qoftë se dëshirojmë ta kemi një shoqëri të pastër dhe në qoftë se dëshirojmë të realizojmë atë moton e Qeverisë - zero tolerancë ndaj korrupsionit.

Ai gjithashtu shtroi çështjen e deklarimit të pasurisë së zyrtareve të lartë, sepse siç shihet nga raporti, gjyqtarët janë ata që nuk e kanë përfillur ligjin.

Vetë ndërhyrja e këtij Agjencioni në vitin e kaluar për anulimin e 13 tenderëve në vlerën diku prej 7 milion eurove tregon dhe mund të lidhet edhe me Raportin e shpenzimeve buxhetore se, vërtet, a është faji te ligji apo është faji te njerëzit që e zbatojnë ligjin rreth këtyre çështjeve.

Dhe, në fund, ne si Komision kërkojmë nga ky Kuvend që të përkrahet ky raport, dhe jo vetëm të përkrahet, por të fuqizohet puna dhe veprimi i këtij agjencioni.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit i dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramadan Avdiu**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxherri**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Radmila Vujovic**, dhe deputetët : **Safete Hadërgjonaj**, **Eqrem Kryeziu**, **Gjylnaze Sylaj**, **Hajredin Hyseni**, **Driton Tali**, **Hajdin Abazi**, **Numan Balić**, **Ramë Buja**, **Naser Rugova**, **Ibrahim Makolli**, **Vezira Emrush**, **Lulzim Zeneli**, **Armend Zemaj**, **Kaqusha Jashari**, **Hydajet Hyseni**, **Rita Hajzeraj**, **Emrush Xhemajli**, **Esat Brajshori**, **Gani Buqinca** dhe **Sala Berisha**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Në mungesë të kuorumit, **Kryetari** e shtyri miratimin e këtij Raporti për seancën e radhës, ndërkaq, në fillim të seancës së 4 qershorit 2008, e hodhi në votim Raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Rezultati i votimit ishte, si vijon :

Për : 83
Kundër : 1
Abstenim: 3

Kryetari Konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2007.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale